



Mirësevini në bibliotekë!

Stafi i bibliotekës gëzohet nga vizita juaj. Gjatë orëve që ajo është e hapur të gjitha mediat janë në dispozicionin tuaj.

Ne bibliotekë ju do të mund të merrni:

- libra
- shtypin periodik
- libra me shkronja
- harta gjeografike
- CD-ROM-e
- kasete
- CD audio
- DVD

Kushtet e huazimit

Një pagesë vjetore prej 55.- Fr. ju lejon të huazoni deri në 20 libra/media.

Huazimi (10 libra/media) është falas deri në moshën 18 vjeç.

Biblioteka do të mbledhë një taksë për rezervimin në 4.- Fr. Ajo ju njofton me shkrim sapo që librat apo mediat janë në dispozicionin tuaj.

Regjistrimi

Për regjistrim biblioteka kërkon një dokument të vlefshëm që mban emrin, mbiemrin dhe fotografinë tuaj. Për lexuesit e vegjël (- 18 vjeç) biblioteka ka nevojë për autorizimin e prindërve ose të përfaqësuesit të tij ligjor.

Faleminderit për mbajtjen me kujdes të librave dhe mediave të tjera. Biblioteka është e detyruar të lëshojë faturë për humbjen dhe dëmtimin e tij.

Kthimi

Ju mundeni t'i mbani mediat/librat deri në datën e shënuar.

Ju lutemi jini të përpiktë ose kërkonit zgjatje të afatit. Të gjitha vonesat do të faturohen.

Autorizimi i prindërve

Fëmijët tuaj dëshirojnë të frekuentojnë dhe të marrin hua libra/media. Biblioteka kërkon autorizimin tuaj.

Marrja hua e librave në bibliotekë është falas për fëmijët tuaj. Nëse ata vonojnë shumë librat/mediat, ne jemi të detyruar që t'ju kërkojmë një taksë. Kujdesuni që fëmijët tuaj t'i mirëmbajnë librat/mediat. Për humbjen ose dëmtimin e tyre do t'ju kërkohej dëmshpërblim.

Shpresojmë se oferta e bibliotekës tonë do t'ju pëlqejë dhe do të gëzoheshim shumë nqs do të flisni për të në rrethin e miqve tuaj ose në shoqata.

Fassung Januar 2019